

QYTETARËT VOTOJNË



NDRYSHIMI VJEN

UDHËHEQJA E QYTETARËVE

JON (10), AGNESA (10), ORGES (10), AURORA (10), EDA (10), JONA (10), UMA (10), SUMEJA (11)

Për të kuptuar se çka kemi mësuar ne sot, lexoni më poshtë artikullin tonë

Sot diskutuam për një temë shumë interesante, që është demokracia. Nga ky diskutim, ne kuptuam se demokracia është shumë e vjetër dhe ka lindur në vitin 507 p.e.s.

Është shumë e vërtetë se ka dallime të mëdha në mes të demokracisë së mëparshme dhe demokracisë së sotme. Zhvillimi i demokracisë ka ndodhur gradualisht, por e rëndësishme është që është bërë një ndryshim i tillë. Themi kështu, sepse më parë, qytetarët nuk kanë qenë të barabartë dhe nuk kanë pasur aq shumë të drejta sa kemi ne sot.

Ndryshimet në demokraci kanë ardhur si rrjedhojë e parimeve të saja, të cilat i kanë vendosur vetë qytetarët. Ato parime janë: barazia, solidariteti, toleranca, liria, paqja, etj. Lumturia jonë është e lidhur ngushtë me këto vlera. Për shembull, çfarë do të ndodhte po të mos u lejohej edhe vajzave të shkollohen njëjtë sikurse djemve? Gjysma e popullit do të ishte e pashkolluar. Ne jemi të gëzuar që një dukuri e tillë nuk do të ndodhë në vendin tonë. Kjo sepse në Kosovë kemi demokraci dhe të gjithë trajtoheni në mënyrë të barabartë e pa asnjë dallim.

Është shumë e rëndësishme është të kemi jetë të mirë. Por, a do të ndodhte kjo nëse në një familje të sigu-

ronte të ardhura vetëm njëri nga prindërit? Më parë, vetëm burrat kanë punuar. Gratë kanë qenë të privuara nga kjo e drejtë. Prandaj, edhe kushtet ekonomike kanë qenë më të vështira se sot. Ndërsa, tani është rritur numri i grave të cilat punojnë dhe kjo tregon se ato nuk dallojnë shumë nga burrat.

Demokracia si formë e qeverisjes, është e përhapur pothuajse në tërë botën. Në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, që do të thotë se si përfaqësues të popullit i kemi deputetët.

Ne u kënaqëm shumë me informatat të cilat i morëm këtu, sepse e kuptuam se sa fatlum jemi që jetojmë në demokraci. Shpresojmë që jeni ndarë të kënaqur me artikullin tonë dhe që keni marrë shumë informacione të rëndësishme.



Jemi gazetarë me vlera, jemi gazetarë të demokracisë



Shkollimi i grave është mëse i domosdoshëm për çdo shtet

LIRIA PËR TË ZGJEDHUR

MEHMET (10), DHURATA (10), ERËZA (10), LEONITA (10), ENIS (10), LEART (11), ERDIN (10)



E ardhmja e popullit është në dorën tonë. Arsimiti ynë është i rëndësishëm për popullin dhe për zhvillimin e vendit tonë


Shteti ynë Kosova është shtet demokratik, ku kemi shumë të drejta. Të drejtat që ne i kemi janë të rëndësishme, sepse ato neve na sigurojnë arsim, argëtim, strehim, mundësi për shprehje të lirë, etj. Demokraci do të thotë të jemi të lirë dhe pa pushtues i cili na pengon arsimimin dhe zhvillimin e popullit tonë.

Një element shumë i rëndësishëm i demokracisë është zgjedhja e lirë. Fëmijët nuk mund të votojnë në procece zgjedhore, sepse ata ende nuk janë të gatshëm për të votuar. Por, kjo nuk do të thotë që nuk munden të votojnë në jetën e tyre të përditshme. Për shembull, sot gjatë punës sonë në grup kemi votuar se kush nga ne do të shkruajë artikullin, e kush do të vizatojë.

Për qytetarët të cilët kanë të drejtë vote, iu themi të votojnë sepse mirë bëjnë.



Autorët e artikullit duke e bërë një 'selfie' gjatë punës



Sepse është e drejtë themelore e njeriut



Votat e qytetarëve janë shumë të vlefshme

NE FËMIJËT JEMI TË RËNDËSISHËM

DIJAR (10), ARTI (10), VLERA (10), ERINA (10), NOTA (10), ERIS (10), FLORESA (10), BLEARD (11)

Të dashur miq, a e keni menduar ndonjëherë sesa janë të rëndësishme ligjet në vendin tonë? Vendi ynë ka ligje, por a respektohen ato nga ne? Për ta kuptuar këtë iu ftojmë ta lexoni artikullin


Ne si fëmijë jetojmë në një vend demokratik, ku populli merr vendime duke zgjedhur përfaqësuesit e vet. Këta përfaqësues, pastaj marrin vendime shumë të rëndësishme për vendin tonë. Institucioni ku merren këto vendime të rëndësishme është Kuvendi.

Ligjet të cilat janë rregulla që duhet të respektohen dhe të zbatohen. Ato miratohen ose nuk miratohen pikërisht në Kuvend. Në rastet kur ligjet nuk respektohen, pasojnë dënime. Mirëpo, ne si qytetarë duhet të jemi të vetëdijshëm për ndikimin që e kanë këto ligje në jetën tonë. Po të mos ishin ato, jeta jonë do të ishte kaos i vërtetë. Pra, duhet ta dimë se ligjet duhet të respektohen për të mirën tonë. Propozimet e ligjeve mund të bëhen nga: deputetët, Qeveria, Presidenti dhe populli (10.000 e më shumë nënshkrime). Ligjet e propozuara bazohen në Kushtetutën e vendit, e cila është ligj mbi ligjet. Për ne fëmijët, fjala demokraci ka shumë vlerë, sepse ne jemi të lirë dhe të gjithë i kemi të drejtat e barabarta. Populli ynë ka nevojë për respekt, dashuri dhe tolerancë ndaj njëri-tjetrit.

Besojmë se e dini që e ardhmja e popullit tonë varet nga ne fëmijët. Kemi porosi për ju lexues të dashur: „Mësoni sa më shumë që ta ngrisni atdheun me dituri. Çdo veprimtari e jona ndikon në atdheun tonë. Pra, ta ruajmë atdheun sikur shqiponja folenë, se të parët tanë u munduan shumë për të arritur këtu ku jemi.“



Grupi „Fëmijët demokratikë“




Jeta jonë rregullohet nga ligjet



Në demokraci, vendimmarrja i takon popullit. Kuvend, i cili ndryshe njihet edhe si „Shtëpia e Popullit“, është institucioni më demokratik i vendit tonë. Aty deputetët të cilët janë përfaqësuesit tanë, diskutojnë çështje me ndikim të madh në jetën e secilit prej neve. Prandaj, të gjithë qytetarët duhet të jenë të kujdesshëm kur i zgjedhin përfaqësuesit

QYTETARIA AKTIVE E NDËRTON DEMOKRACINË

AMAR (10), ARIANIT (10). AJLA (10), ERALDA (10), EDI (10), VESA (10), RIGA (10), SUELA (10)



Më të mirët prej personave janë ata, të cilët mendojnë për pjesën tjetër të shoqërisë. Se si mund të jemi në shërbim të të tjerëve duke iu ndihmuar atyre, do t'i tregojmë ne

Në çdo shoqëri, roli i qytetarëve është faktor përcaktues i ndërtimit të shtetit. Këtë e kemi kuptuar që kur ishim të vegjël. Që atëherë, ne kemi dëgjuar nga anëtarët e familjes, se populli është ai që duhet të luaj rol aktiv për të vënë në funksion idetë që mund t'i ketë. Duke parë shembuj të ndryshëm se si qytetarët janë aktivizuar në komunitete të ndryshme dhe me iniciativa të ndryshme, ne kemi marrë model se si mund të jemi të fillë edhe ne.

Siç edhe e dijmë, qytetarë jemi të gjithë. Megjithatë, ajo që na dallon është se a jemi qytetarë aktiv apo pasiv. Normalisht se roli pasiv nuk mund të ndikoj në zhvillimin e demokracisë. Prandaj, ne kemi zgjedhur të kemi rol aktiv. Në rolin aktiv të qytetarëve përfshihen: zbatimi i të gjitha elementeve të demokracisë, ndihma e ofruar ndaj të tjerëve, iniciativat pozitive, respektimi i ligjeve dhe rregullave, si dhe puna vullnetare. Ne po ndalemi të diskutojmë pak për punën vullnetare dhe rëndësinë e saj. Në shkollën tonë, ne kemi marrë një hap të vogël se si ta mbajmë shkollën tonë të pastër. Jemi aktivizuar duke propozuar ide si mund ta bëjmë këtë, pastaj i kemi njoftuar të tjerët dhe së bashku kemi pastruar ambientin e shkollës. Kjo iniciativë ishte shumë efektive edhe për shëndetin tonë, por edhe



Pastërtia është gjysma e shëndetit

për ambientin e shkollës. Po ashtu, nga kjo punë që e kemi bërë në mënyrë vullnetare, kanë marrë shembull edhe nxënësit e tjerë të shkollës. A po e shihni të dashur lexues se si një punë vullnetare sado e vogël mund të sjell ndryshim të madh në vend? E pse mos të jeni edhe ju ndryshues të rinjë? Ejani me ne, t'i propozojmë idetë tona dhe të aktivizohemi që t'i vëmë në funksion ato. Ne mundemi!



Ne jemi qytetarë aktiv, sepse e duam shtetin tonë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mustafë Venhari“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri